

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8273  
E enjte, 2 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

17 vjet nga anëtarësimi në NATO, Begaj: Shqipëria, aleate e palëkundur për paqen dhe sigurinë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI DEKORON KOMBËTAREN E KOSOVËS ME "MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE"

## KOMBËTARJA NDEROHET ME 'MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE'

FAQE 4-5



Presidentja Vjosa Osmani ka dekoruar Kombëtaren e Kosovës në futboll me "Medaljen Presidenciale të Meritave" për përfaqësimin dinjitoz të vendit tonë në arenën ndërkombëtare ani pse nuk ka arritur ta sigurojë biletën për Kupën e Botës,

duke u mposhtur mbrëmë nga Turqia në finalen e "play-off"-it. Osmani ka thënë se rruga e Kombëtares do të jetë e ndritshme. Ndërsa presidenti i FFK-së, Agim Ademi, duke falënderuar Osmanin për medaljen, ka thënë se djelmohat dardanë kanë fituar zemrat e një kombi. Ai ka

shprehur bindjen se do të vijë dita kur Kombëtarja e Kosovës do të marrë medalje në arenën ndërkombëtare. Ndërsa kapiteni Vedat Muriqi ka shprehur krenari për përfaqësimin e vendit dhe optimizëm për të ardhmen e Kombëtares

### AKTUALE



HAMZA I SHKRUAN OSMANIT: EMËRONI PA VONESË ANËTARIN E DYTË TË PDK-SË NË KOZ, MOSVEPRIMI ËSHTË SHKELJE KUSHTETUESE | F. 3

PËRKUJTOHEN TË RËNËT NË MASAKRËN E LYBENIQIT: QËLLIMI I SERBISË ISHTE SHFAROSJA E SHQIPTARËVE | F. 6

BAJRAMI: KURTI, FAJTORI KRYESOR NËSE VENDI SHKON NË ZGJEDHJE | F. 7

### EKONOMI



AKB-ja: PAGA E 13 VETËM PËR SEKTORIN PUBLIK, E PAPANUESHME DHE DISKRIMINUESE | F. 8

KOMISIONI PËR BUXHET MIRATON MARRËVESHJEN E KREDISË PËR SEKTORIN FINANCIAR, PDK-JA VOTON KUNDËR | F. 8

### SPORT



KËTO JANË KOMBËTARET QË DO TË MARRIN PJESË NË KUPËN E BOTËS | F. 11



KËMBËNGULË MBROJTJA E THAÇIT: ZPS-ja PO SHKEL RREGULLIN 136 TË RREGULLORES SË GJYKATËS SPECIALE | F. 3



DEPUTETËT U FRIKËSOHEN ZGJEDHJEVE TË REJA, THEKSOJNË NEVOJËN E STABILITETIT INSTITUCIONAL | F. 7

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Trumpi: Po shqyrtoj seriozisht tërheqjen e ShBA-së nga NATO

WASHINGTON, 1 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka thënë se është duke e shqyrtuar seriozisht nxjerrjen e ShBA-së nga NATO pasi aleatët nuk e kanë mbështetur veprimin ushtarak amerikan

kundër Iranit, sipas një interviste dhënë gazetës britanike "Daily Telegraph". Trumpi e ka përshkruar aleancën si një "tigër prej letre" dhe ka thënë se largimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) nga pakti i

mbrojtjes tani është "përtej rishqyrtimit". Ai ka thënë se prej kohësh ka dyshime për besueshmërinë e NATO-s. "Oh po, do të thosha (se është) përtej rishqyrtimit", i ka thënë Trumpi gazetës britanike kur është pyetur nëse do ta

rishqyrtonte anëtarësimin e ShBA-së në aleancë pas konfliktit. "Unë kurrë nuk jam ndikuar nga NATO. Gjithmonë e kam ditur se ata ishin një tigër prej letre dhe Putini e di këtë gjithashtu, meqë ra fjala", ka thënë Trumpi.



## NJË VENDTAKIM I RI PËR SAMITIN E BËRDO-BRIONIT PO SHQYRTOHET

LUBJANË, 1 PRILL - Është duke u punuar për të gjetur një vendndodhje tjetër për mbajtjen e samitit të Bërdo-Brionit, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" zyra e presidentit të Sllovenisë. Takimi i sivjetshëm i kësaj nisme 13-vjeçare është anuluar nga presidenti i Kroacisë, Zoran Millanoviç.

Millanoviç ka thënë në arsyetimin e tij se nuk ka kushte që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të vijë në Kroaci për këtë samit, duke shtuar se deklaratat e liderit serb e prishin paqen dhe stabilitetin. Vuçiq është përgjigjur se në vend që ta anulonte takimin, Millanoviç mund të kishte ftuar "miqtë e tij nga Prishtina dhe Tirana". Gjatë vitit të kaluar, presidenti serb e ka akuzuar Kroacinë për ndërhyrje në punët e brendshme të Serbisë, por nuk dhënë asnjë provë për këtë. Bashkimi Evropian (BE) ka reaguar gjithashtu ndaj anulimit të samitit, duke shprehur keqardhje. "Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë në thelb të procesit të integritimit evropian dhe pjesë thelbësore e rrugës së Serbisë drejt BE-së", ka thënë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier. Kroacia dhe Sllovenia, si anëtarë të BE-së, kanë iniciuar procesin e Bërdo-Brionit, me qëllim për të nxitur bashkëpunim dhe



përshpejtim të integritimit të rajonit në BE.

Përveç presidentëve të Kroacisë, Sllovenisë dhe Serbisë, në procesin e Bërdo-Brionit marrin pjesë edhe liderët e Malit të Zi, Bosnje e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

Millanoviç, si bashkëkryetar i procesit të Bërdo-Brionit, ka njoftuar krerët e shteteve pjesëmarrëse se kishte vendosur ta anulonte takimin e planifikuar të mbahej në maj në Kroaci.

Zyra e presidentes sllovene, Natasha Pirc Musar, siç ka marrë vesh "Radio Evropa e Lirë" është u njoftuar menjëherë për

vendimin e Millanoviçit. "Ky është një vendim i brendshëm politik i Presidentes së Kroacisë, në të cilin ne nuk mund të ndërhyjmë dhe për këtë arsye nuk e komentojmë", është thënë në përgjigje.

Presidenca sllovene ka thënë se këshilltarët e politikës së jashtme të presidentit të Sllovenisë dhe të presidentit të Kroacisë mbeten në kontakt të rregullt me qëllim që të sigurohet që samiti i procesit të Bërdo-Brionit në vitin 2026 të mbahet në një vend alternativ.

Nga Zagrebi është njoftuar se takimi i ardhshëm i krerëve të shteteve të Bërdo-Brionit do të

mbahet kur të jenë kushtet e duhura dhe pas konsultimeve midis bashkëkryetarëve, Millanoviç dhe Pirc Musar. Anulimi i samitit të Bërdo-Brionit, për Jelica Miniç nga Lëvizja Evropiane joqeveritare në Serbi, është një lajm i keq për Serbinë dhe rajonin. Ajo ka thënë se Serbia, deri në fillim të kësaj dekade, luajti rol të rëndësishëm dhe përfitoi kryesisht nga bashkëpunimi në të cilin ishte e përfshirë. Presidenti kroat, Millanoviç ka vlerësuar se deklaratat dhe veprimet e homologut serb në ditët dhe javët e fundit janë plotësisht në kundërshtim me

qëllimin e procesit të Bërdo-Brionit. Ai ka thënë se ato prishin marrëdhëniet ndërshtetërore dhe kërcënojnë paqen dhe stabilitetin në rajonin e Evropës Juglindore. Në muajt e fundit, Vuçiqi ka akuzuar Kroacinë, Shqipërinë dhe Kosovën se marrëveshja e tyre për bashkëpunim në mbrojtje do të thotë aleancë ushtarake kundër Serbisë, gjë që është mohuar vazhdimisht nga këto vende.

Analisti politik kroat, Jaroslav Pecnik, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se qëndrimet e Serbisë dhe Kroacisë janë aq të ngulitura në këtë pikë sa një takim nuk do të kontribuonte në mirëkuptim të ndërsjellë. Megjithatë, ai ka vlerësuar se anulimi i samitit nuk është goditje ndaj stabilitetit rajonal sepse Millanoviç nuk ka ndikim të madh në politikën rajonale. Për më shumë se një vit, Vuçiqi ka akuzuar Kroacinë dhe shërbimet e saj për ndërhyrje në punët e brendshme të Serbisë, pa dhënë asnjë provë. Para vendimit të Millanoviçit për të anuluar samitin, Vuçiqi ka deklaruar se do të "kontrollonte raportet nga agjencitë e sigurisë në lidhje me ndikimin e mundshëm nga vendet e huaja" në zgjedhjet lokale në Serbi, duke përmendur "mbështetjen logjistike nga një vend fqinj".

## Irani gati ta ndalë luftën, presidenti Pezeshkian: Duam garanci të mos ketë sulme sërish

TEHERAN, 1 PRILL - Presidenti i Iranit, Masoud Pezeshkian, ka deklaruar se vendi i tij ka vullnetin e nevojshëm për t'i dhënë fund konfliktit të vazhdueshëm me Izraelin dhe Shtetet e Bashkuara, por ka theksuar se kërkon garanci që një përshkallëzim i tillë të mos përsëritet në të ardhmen.

Zyra e Pezeshkianit ka shpërndarë këtë mesazh pas një bisede që presidenti iranian ka zhvilluar me presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa. Ai ka theksuar se përfundimi i konfliktit është i mundur vetëm nëse plotësohen disa kushte

thelbësore, veçanërisht sigurimi i garancive për të parandaluar përsëritjen e "agresionit".

"Ne kemi vullnetin e nevojshëm për t'i dhënë fund këtij konflikti, me kusht që të përmbushen kushtet thelbësore, sidomos garancitë e kërkuara për të mos lejuar përsëritjen e agresionit", citohet të ketë thënë ai.

Nga ana tjetër, Costa ka reaguar pas bisedës përmes një postimi në rrjetet sociale, duke paralajmëruar se situata aktuale në Lindjen e Mesme është "jashtëzakonisht e rrezikshme" dhe duke i bërë thirrje Iranit të ulë tensionet.

Për ta shmangur përshkallëzimin e mëtejshëm, ai i ka kërkuar Iranit t'i ndalojë sulmet që i ka cilësuar si të papranueshme ndaj vendeve të rajonit dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive në rrugën diplomatike, veçanërisht në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara për ta garantuar lirinë e lundrimit në ngushticën e Hormuzit. Kërkesa e Antonio Costas për ulje të tensioneve dhe hapje të ngushticës së Hormuzit vjen në kohën kur Evropa ka refuzuar t'i bashkohet operacionit ushtarak amerikano-izraelit mbi Iranin. Presidenti iranian Masoud



Pezeshkian ka paralajmëruar presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa, gjatë telefonatës, se ndërhyrjet e

jashtme në këtë konflikt do të sillnin pasoja serioze për Evropën, duke paralajmëruar kështu hakmarrje nga Teherani.

# KËMBËNGULË MBROJTJA E THAÇIT: ZPS-ja PO SHKEL RREGULLIN 136 TË RREGULLORES SË GJYKATËS SPECIALE

HAGË, 1 PRILL - Mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi po vazhdon ta kontestojë ligjshmërinë e dorëzimit të provave nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Avokati kryesor i Thaçit, Lluka Mishetiç, sërish në kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, ka kërkuar që kjo e fundit ta ndalojë dorëzimin e provave pas mbylljes së çështjes kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Fillimisht, me datën 13 mars kishte kërkuar nga trupi gjyqësor që të urdhërojë prokurorinë për mosparaqitje të provave. Ndërsa më 25 mars, kryeprokurorja e Specializuar, Kimberly West, i është përgjigjur kërkesës, duke kërkuar refuzimin e saj. ZPS-ja ka thënë se zbulimet në fjalë i plotësojnë të gjitha kriteret dhe "nuk përbëjnë paraqitjen e 'parashtrësive' apo 'paraqitjen e provave'". "Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për një urdhër ndaj ZPS-së në bazë të Rregullës 136 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, dhe shpërfill zbatimin e Rregullës 112 dhe jurisprudencën e Dhomave të Specializuara lidhur me të. Përmbushja nga ana e Zyrës së

Prokurorit të Specializuar (ZPS) e detyrimeve të saj të vazhdueshme të zbulimit të provave, në përputhje me kornizën e aplikueshme, nuk përbën paraqitje provash, apo paraqitje të parashtrësive, në kuptimin e Rregullës 136. Kërkesa duhet të refuzohet në përputhje me këtë", është thënë në parashtrimin e ZPS-së.

Por, më 30 mars, mbrojtja i është kundërpërgjigjur këtij parashtrimi, duke vlerësuar se qëndrimi i ZPS-së bazohet në "interpretim të gabuar" dhe "nëse nuk ndryshohet 'do të lejonte një shkelje të vazhdueshme për gjykim të drejtë'". "Mbrojtja e z. Hashim Thaçi (mbrojtja) me këtë i përgjigjet parashtrimin të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) lidhur me kërkesën e mbrojtjes për një urdhër në bazë të Rregullës 136 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Qëndrimi i ZPS-së bazohet në një interpretim të gabuar të rregullave 112 dhe 136, i cili, nëse lihet i pandryshuar, do të lejonte një shkelje të vazhdueshme të drejtës themelore të z. Thaçi për një gjykim të drejtë", është thënë në përgjigjen e avokatit Lluka

Mishetiç.

Avokati kryesor i ish-presidentit, Hashim Thaçi, përmes parashtrimeve të tij ka shprehur shqetësimin se paraqitja e njëanshme e provave nga ZPS-ja nuk garanton proces të drejtë. "Kjo paraqitje e 'fshehtë' e provave shkel parimin e barazisë së 'armëve' dhe të drejtën për t'u komentuar mbi provat e paraqitura para gjykatësit të faktit, siç garantohej nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Brandstetter kundër Austria), Neni 31 i Kushtetutës dhe Ligji (vendim i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese që shqyrton dhe konfirmon përputhshmërinë kushtetuese të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës)", është thënë në parashtrimin të mbrojtjes së Thaçit. Mbrojtja sërish përmes kësaj kundërpërgjigjeje ndaj ZPS-së ka kërkuar nga trupi gjyqësor që të urdhërojë këtë të fundit për mos dërgimin e këtyre provave. Por, çfarë thotë Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, saktësisht rregulla 136? "Pas deklaratave përmblylëse, kryetari i trupit gjyqësor deklaroi



çështjen të mbyllur. Në këtë fazë trupit gjyqësor nuk mund t'i paraqitet asnjë parashtrim tjetër, përveç se në rrethanat të posaçme dhe duke treguar arsye të vlefshme. Në këtë fazë trupit gjyqësor nuk mund të pranojë asnjë parashtrim, apo të dëgjojë dëshmi të tjera, përveç nëse diktohet prej rrethanave të posaçme", thuhet në këtë rregullore.

Ky debat vjen pas mbylljes së kësaj çështjeje ndaj katërshes së UÇK-së dhe kur ky rast tanimë është në duart e gjykatësve për vendim. Më 9 shkurt të këtij viti në Dhomat e Specializuara kanë nisur fjalët përmblylëse në rastin Thaçi dhe të tjerët. Katërshja e UÇK-së me 18

shkurt kanë paraqitur fjalët e tyre prej 20 minutash, ku janë deklaruar sërish të pafajshëm për të gjitha akuzat që i ngarkon Zyra e Prokurorit të Specializuar. Edhe ekipet mbrojtëse të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit kanë kërkuar që të njëjtë të shpallen të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Kryeprokurorja e Specializuar, Kimberly West ka kërkuar dënim me burgim prej 45 vitesh, për secilin nga ish-krerët e UÇK-së, me pretendimet për krime lufte. Gjykimi ndaj tyre ka nisur më 3 prill 2023, gati tri vjet pas konfirmimit të aktakuzës prej kur krerët e UÇK-së mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë.

## HAMZA I SHKRUAN OSMANIT: EMËRONI PA VONESË ANËTARIN E DYTË TË PDK-SË NË KQZ, MOSVEPRIMI ËSHTË SHKELJE KUSHTETUESE

PRISHTINË, 1 PRILL - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, i ka dërguar një letër zyrtare presidentes së vendit, Vjosa Osmani, duke kërkuar që të procedohet pa vonesë emërimi i anëtarit të dytë të PDK-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë letër, kryetari Hamza ka theksuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin KO81/26 ka sqaruar përfundimisht çdo paqartësi lidhur me këtë çështje, duke konfirmuar se përfaqësimi i PDK-së me dy anëtarë në KQZ është e drejtë kushtetuese dhe jo çështje interpretimi politik. Sipas tij, mosveprimi në këtë fazë do të përbente shkelje të rendit kushtetues dhe do të krijonte



precedent të rrezikshëm për funksionimin demokratik të institucioneve në vend.

Ai i ka bërë thirrje presidentes Osmani të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke garantuar respektimin e të drejtave të subjekteve politike dhe

integritetin e KQZ-së.

Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të papranueshme kërkesën e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Osmani kishte kërkuar vlerësimin e "konfliktit në mes të

kompetencave kushtetuese sipas nenit 113" të Kushtetutës, përkatësisht në mes të saj dhe "grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit të Kosovës" sa i përket emërimit të anëtarëve të KQZ-së. Kushtetuesja ka thënë se nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara kushtetuese në lidhje me ngritjen e "konfliktit të kompetencave kushtetuese".

Gjykata Kushtetuese ka treguar se në rastin konkret, konflikti i kompetencave është ngritur me një kompetencë të presidentes që nuk është përcaktuar me Kushtetutë, por me Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme. Kjo kompetencë buron nga paragrafi 6 i nenit 61 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjykata ka theksuar

se edhe në pjesën e Kushtetutës që ka të bëjë me format e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit në asnjë pjesë nuk përcaktohet specifikisht nëse presidenti i Kosovës ka kompetencën t'i emërojë anëtarët e KQZ-së. "Në vlerësimin e Gjykatës në rrethanat e rastit konkret, presidentja e Republikës, ndonëse është palë e autorizuar që të ngrehë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të saj dhe Kuvendit, nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të 'kompetencave kushtetuese' si dhe, për pasojë, Gjykata e shpall kërkesën e presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme", është thënë në vendimin e Kushtetueses.

## 17 vjet nga anëtarësimi në NATO, Begaj: Shqipëria, aleate e palëkundur për paqen dhe sigurinë

TIANË, 1 PRILL - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka përkujtuar 17-vjetorin e anëtarësimin të shtetit shqiptar në NATO, duke e theksuar si një arritje historike që ka forcuar sigurinë, sovranitetin dhe rolin e saj në aleancën Euroatlantike. Begaj ka vlerësuar kontributin e Shqipërisë si një aleate e denjë në shërbim të paqes dhe sigurisë

ndërkombëtare, duke theksuar angazhimin e vazhdueshëm të vendit në misionet dhe operacionet e Aleancës. Presidenti Begaj ka shprehur krenarinë për përkushtimin dhe profesionalizmin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë kontribuar me dinjitet krah aleatëve kudo sa herë dhe ku

është kërkuar kontributi i tyre. Ai ka theksuar se Shqipëria mbetet e palëkundur në përkushtimin e saj për të qenë një faktor stabiliteti dhe sigurie dhe se krah aleatëve të saj ajo do të vijojë të kontribuojë për paqen, stabilitetin dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt për të gjithë. "Si aleancë e vlerave demokratike, NATO është garant i paqes, sigurisë dhe

mbrojtjes kolektive në hapësirën euroatlantike. Shqipëria është një aleate e denjë, kontribuuese aktive në misionet dhe operacionet e saj. Krenarë për përkushtimin dhe profesionalizmin e Forcave tona të Armatosura! Mbetemi të bashkuar për paqen, stabilitetin dhe një të ardhme më të sigurt për të gjithë", ka thënë Begaj.





PRESIDENTJA VJOSA OSMANI DEKORON KOMBËTAREN E KOSOVËS ME “MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE”

## KOMBËTARJA NDEROHET ME “MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE”

Presidentja Vjosa Osmani ka dekoruar Kombëtaren e Kosovës në futboll me “Medaljen Presidenciale të Meritave” për përfaqësimin dinjitoz të vendit tonë në arenën ndërkombëtare ani pse nuk ka arritur ta sigurojë biletën për Kupën e Botës, duke u mposhtur mbrëmë nga Turqia në finalen e “play-off”-it. Osmani ka thënë se rruga e Kombëtares do të jetë e ndritshme. Ndërsa presidenti i FFK-së, Agim Ademi, duke falënderuar Osmanin për medaljen, ka thënë se djelmoshat dardanë kanë fituar zemrat e një kombi. Ai ka shprehur bindjen se do të vijë dita kur Kombëtarja e Kosovës do të marrë medalje në arenën ndërkombëtare. Ndërsa kapiteni Vedat Muriqi ka shprehur krenari për përfaqësimin e vendit dhe optimizëm për të ardhmen e Kombëtares

**EPOKA  
ERE**

**Lirim GECI**

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekoruar Kombëtaren e Kosovës në futboll me “Medaljen Presidenciale të Meritave” në një ceremoni të mbajtur një ditë pas ndeshjes së “play-off”-it kundër Turqisë (0:1). Në fjalën e saj, presidentja Osmani ka theksuar se, pavarësisht prej rezultatit në këtë përballje, Kombëtarja e Kosovës mbetet një nga përfaqësimet më dinjitoze të shtetit në arenën ndërkombëtare. “Pavarësisht prej rezultatit, ju do të mbeteni në piedestalin më të lartë të Republikës sonë për krenarinë që i keni bërë popullit tonë. Prandaj, në emër të shtetit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, ju falënderojmë për gjithçka që

keni bërë dhe vazhdoni të bëni për vendin tonë. Kontributi juaj është pjesë e pandashme e historisë sonë sportive dhe, mbi të gjitha, frymëzim i fuqishëm për brezat që vijnë. Në bazë të kompetencave të mia kushtetuese si presidente e Republikës së Kosovës, kam vendosur që Kombëtaren e Republikës në Futboll ta dekoroj me Medaljen Presidenciale të Meritave, me motivacionin: ‘Për përfaqësim dinjitoz të shtetit tonë në arenën ndërkombëtare; për krenarinë që i kanë dhënë shtetit tonë; si dhe për arritjen në fazën finale të kualifikimeve për Kampionatin Botëror’. Dhe jo vetëm me shpresën, por me besimin e plotë që rruga përpara do të jetë edhe shumë më e ndritshme. Të nderuar përfaqësues të kombëtares, duke e ditur që shumica e lojtarëve tashmë janë rikthyer

në vendet ku punojnë dhe ku luajnë, jam e nderuar që ju kemi sot si përfaqësues nga institucioni i Presidencës së Republikës së Kosovës që ta pranoni këtë dekoratë në emër të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilëve u keni dhënë emocione dhe krenari pa fund”, ka thënë presidentja Osmani. Ndërsa në emër të komunitetit të futbollit, presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka shprehur mirënjohjen për këtë vlerësim, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes institucionale për zhvillimin e futbollit në vend. “Kjo është medalja më e çmuar, medalja e shtetit tonë dhe medalja e popullit tonë. Ne vërtet nuk shkuam në Kupën Botërore, por fituam një medalje të shtetit tonë, zemrat e shtetit tonë, e cila për ne është shumë e rëndësishme, sepse ne jemi

të këtij shteti. Ne si federatë dhe si futbollistë jemi shumë të lumtur që kemi pasur një bashkëpunim kaq të mirë dhe kaq të afërt me presidenten tonë, e cila na ka ndihmuar gjithmonë, me dekretet për futbollistët dhe me praninë e saj çdo herë, edhe kur kemi qenë mirë, edhe kur kemi qenë keq. Prandaj, gjithmonë mirënjohës si federatë, si futboll dhe në emër të gjithë komunitetit të futbollit, që jemi mbi 57 700 persona, ju falënderoj shumë dhe ju dëshiroj sukses në rrugëtimin tuaj politik. Gjithashtu, besoj se edhe në të ardhmen do të jemi bashkë. Sigurisht një ditë do të vijë edhe momenti që ne të marrim një medalje të Kampionatit Evropian”, ka thënë Ademi. Kurse në emër të Kombëtares së Kosovës, kapiteni Vedat Muriqi ka shprehur krenari për përfaqësimin e vendit dhe optimizëm për të ardhmen e ekipit. “Fillimisht ju falënderoj për mikpritjen dhe që na nderuat me këtë medalje. Ne e kemi ditur edhe para ndeshjes sa është dëshira e madhe e gjithë popullit dhe gjithë shqiptarëve anembanë botës. Dhe të them të drejtën, nuk kemi besuar se do të humbim. As biletën kthyesë nuk e kam. Ka qenë një goditje e madhe për ne, edhe pse mendoj se

nuk e merituar humbjen. Kemi luftuar shumë dhe kemi bërë çmos që ta bëjmë ëndrrën realitet. Në emër të ekipit ju falënderoj nga zemra juve presidente, shtetin e Kosovës, popullin tonë, mediet dhe federatën. Ne kemi treguar se nëse e vazhdojmë rrugëtimin bashkë, mund ta kalojmë çdo betejë. Kështu që, po shpresojmë në të ardhmen sepse kemi një gjeneratë shumë të mirë, një gjeneratë e artë po vjen. Akoma nuk e kemi arritur gjeneratën e artë. Unë jam shumë krenar me veten që jam pjesë e stafit të Kosovës. Si kapiten i Kosovës, kisha pasur shumë dëshirë ta udhëheq ekipin në Amerikë, por ndonjëherë fati nuk të përcjellë. Kështu që, ju falënderoj të gjithëve në emër të ekipit dhe shpresoj që takimin e radhës ta kemi për një kualifikim në Evropian ose Botëror”, ka thënë Muriqi. Dekorimi i Kombëtares vjen si vlerësim për arritjet dhe përfaqësimin dinjitoz të Kosovës në arenën ndërkombëtare si dhe për rrugëtimin e suksesshëm deri në fazën finale të kualifikimeve për Kupën e Botës. Pavarësisht prej mosrealizimit të “ëndrrës amerikane”, futbollistët e Kosovës janë vlerësuar lart për paraqitjen e tyre dinjitoze në



kualifikimet për Kupën e Botës. Ata kanë fituar zemrat e çdo shqiptari kudo në botë dhe kanë bërë krenar një komb.

### Kosova ndalet në finale të "play-off"-it, por qëndron me kokën lart

Një moment i vetëm ka vendosur fatin e finales së "play-off"-it Kosovë - Turqi për kualifikim në Kupën e Botës, duke i lënë "dardanët" shumë pranë realizimit të një ëndre historike. Goli i shënuar nga Kerem Akturkoglu në minutën e 53-të ia ka dhënë fitoren Turqisë (1:0) në stadiumin e stërmbushur "Fadil Vokrri", në një përballje të luftuar deri në fund nga "dardanët".

Kombëtarja e Kosovës ka zhvilluar një ndeshje dinjitoze përballë një kundërshtari cilësor, duke treguar karakter, organizim dhe përkushtim maksimal. Ndeshja ishte e balancuar në pjesën më të madhe, me të dyja skuadrat që krijuan momente të rrezikshme, por që në fund është vendosur nga një aksion i shpejtë i mysafirëve. Pas një kombinimi në krahun e majtë nga Kenan Yildiz dhe një goditjeje të Orkun Kokçu, topi ka përfunduar tek Akturkoglu, i cili nga afërsia me portën ka realizuar golin e vetëm të takimit. Pavarësisht prej disavantazhit, Kosova ka reaguar dhe kërkuar me ngulm golin e barazimit. Rastet nuk kanë munguar për Kosovën. Fisnik Asllani ka goditur shtyllën në pjesën e parë, ndërsa përpjekje serioze patën edhe Vedat Muriqi, Florent Muslija e Veldin Hoxha në pjesën e dytë. Megjithatë, përkundër dominimit në periudha të caktuara dhe insistimit të vazhdueshëm, goli ka munguar. Ky eliminim në hapin e fundit padyshim dhemb, por rrugëtimi i Kosovës në këtë fushatë kualifikuese është dëshmi e rritjes së vazhdueshme të ekipit. Fitoret e rëndësishme dhe paraqitjet e mira ndaj kundërshtarëve të fortë janë një bazë e fuqishme për të ardhmen.

"Dardanët" largohen nga kjo sfidë me krenari dhe me besimin se sukcesi i madh është çështje kohe. Mbështetja e jashtëzakonshme nga tifozët dhe paraqitjet në fushë japin sinjale të qarta se Kombëtarja jonë është në rrugën e duhur për t'i arritur objektivat në kualifikimet e ardhshme.

### "BBC" shkruan për Kosovën: Një ëndërr e madhe që u ndal në prag të historisë

Mediumi prestigjioz "BBC" i ka kushtuar vëmendje rrugëtimit të Kombëtares së Kosovës në përpjekjen për një kualifikim historik në Kupën e Botës,



duke e përshkruar atë si një histori të shpejtë zhvillimi dhe ambicijeje të madhe. Në artikullin e saj, "BBC"-ja ka theksuar se humbja vendimtare i ka dhënë fund ëndërrës së Kosovës për pjesëmarrjen e parë në një

Botëror, më pak se një dekadë pasi ka zhvilluar ndeshjen e parë kualifikuese. Ky fakt, sipas mediumit britanik, tregon përparimin e jashtëzakonshëm të një përfaqësueseje të re në arenën ndërkombëtare. "Humbja i dha fund ëndërrës së Kosovës për një paraqitje të parë në Kupën e Botës, më pak se 10 vjet pasi luajti ndeshjen e parë kualifikuese për Kupën e Botës. Shteti ballkanik, i cili shpalli pavarësinë në vitin 2008, u lejua ta luante ndeshjen e parë nga FIFA në mars të vitit 2014 - një barazim 0-0 me Haitin. Ndeshja e tij e dytë ishte një humbje 6-1 ndaj Turqisë. Kosova e përfundoi grupin kualifikues vetëm tri

pikë pas Zvicrës dhe një vendi të drejtpërdrejtë në Kupën e Botës të kësaj vere. Kjo bëri që ajo të përballlej me Sllovakinë në gjysmëfinalen e 'Path C', duke fituar një ndeshje emocionuese 4-3, por nuk arriti ta thyejë Turqinë në



## Ambasada e ShBA-së lavdëron Kombëtarën e Kosovës: Arritja juaj është e paharrueshme dhe jashtëzakonshme


Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka lavdëruar Kosovën pas ndeshjes me Turqinë, duke thënë se futbollistët kanë luajtur me zemër, vendosmëri dhe krenari. Ambasada ka vlerësuar se ajo çfarë ka arritur Kosova është e jashtëzakonshme dhe e

paharrueshme. "Një përpjekje e shkëlqyer nga ekipi kombëtar i Kosovës - luajtët me zemër, vendosmëri dhe krenari. Ajo që arritët është vërtet e jashtëzakonshme dhe e paharrueshme", është thënë në reagimin e Ambasadës së ShBA-së.

ndeshjen historike vendimtare ku fituesi merret gjithçka", ka shkruar "BBC"-ja.

### "New York Times": Kosova do të kthehet

Gazeta e njohur amerikane "The New York Times" ka shkruar për ndeshjen vendimtare për Botërorin, të cilën Kosova e ka humbur ndaj Turqisë me rezultat minimal. "The Athletic" e "New York Times"-it kanë shkruar se, pavarësisht prej humbjes, Kosova do të këndellet dhe do ta bëjë përpjekjen e radhës për kualifikim në kampionate. Gazeta njujorkeze ka shkruar edhe për atmosferën që ka mbretëruar të martën në Prishtinë gjatë tërë ditës. "Prishtina ishte mikpritëse për tifozët turq, mirëpo nikoqirllëku nuk shërbeu për një natë të mirë të ekipit vendas. Fansat e tyre e bënë të pamundurën që kombëtarja jofavorite në këtë takim ta bënte përpjekjen historike për ta siguruar Botërorin e tyre të parë. Atmosfera nisi të bëhej shumë herët në atë që ishte një prej ngjarjeve më të mëdha sportive në historinë e Kosovës", ka shkruar "The New York Times". "New York Times" ka shkruar se qytetarët e Kosovës po bënin përpjekjet më të mëdha që kombëtarja ta siguronte biletën për Botërorin në ShBA. "Pjesërisht sepse shumë prej tyre ende e shohin ndikimin amerikan në historinë e Kosovës. Prishtina ka



bulevardin 'Bill Clinton', një statujë të tij dhe një këngë e famshme këtu ishte: 'Thank you, USA. Krejt janë frymëzim nga roli i administratës së Bill Clintonit në intervenimin vendimtar të NATO-s për ndërhyrje në Kosovë më 1999', ka shkruar "New York Times". Kjo gazetë ka shkruar se performanca në pjesën e parë u ka dhënë shpresë vendësve. Goditja nga distanca e Fisnik Asllanit është pritur nga portieri Cakir. "Dhe zhurma ishte e madhe po aq sa fishekzjarrët e fillimit të takimit. Kosova do të kthehet, por kjo ishte natë për t'u harruar në Prishtinë", ka shkruar gazeta njujorkeze.

## Konkursi për radiologë në pikëpyetje, Shoqata kërkon anulim për shkak të parregullive


PRISHTINË, 1 PRILL - Shoqata e Radiologëve e Kosovës ka reaguar lidhur me procedurën e konkursit për pozitën e mjekut specialist në Radiologji, duke ngritur shqetësime serioze për parregullsi profesionale dhe metodologjike gjatë testimit dhe vlerësimit të kandidatëve. Në reagimin e kësaj shoqate është thënë se disa nga pyetjet e

testit dhe çelësi zyrtar i përgjigjeve kanë qenë të pasakta dhe jo në përputhje me standardet e literaturës profesionale, duke cenuar kështu parimet e barazisë, objektivitetit dhe meritokracisë. Në veçanti, kjo shoqatë ka theksuar rastet e pyetjeve konkrete, si ato me numër 14 dhe 12, ku sipas analizës

profesionale kanë ekzistuar më shumë alternativa të sakta sesa ato të pranuar nga komisioni vlerësues.

Sipas këtij dokumenti, Shoqata e Radiologëve të Kosovës ka kërkuar anulimin e plotë të procedurës së konkursit, si masa e vetme efektive për rikthimin e ligjshmërisë dhe besimit në proces. Po ashtu, Shoqata e

Radiologëve e Kosovës u ka bërë thirrje institucioneve kompetente që të trajtojnë këtë çështje me seriozitet dhe transparencë, në mënyrë që të garantohen standardet profesionale në sistemin shëndetësor. Po me të njëjtat pretendime dhe ankesat e bëra, është anuluar edhe konkursi për pozitën oftalmolog.



## PËRKUJTOHEN TË RËNËT NË MASAKRËN E LYBENIQIT: QËLLIMI I SERBISË ISHTE SHFAROSJA E SHQIPTARËVE

PEJË, 1 PRILL - Të martën është shënuar 27-vjetori i të rënëve në masakrën e Lybeniqit në Pejë, e cila vlerësohet një nga krimet më të rënda që Serbia ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Më 1 prill të vitit 1999, në orët e hershme të mëngjesit, forcat serbe, të udhëhequra nga grupi i njohur "Çakejt", kishin rrethuar fshatin Lybeniq në Pejë. Pas hyrjes në Lybeniq, ato i kishin tubuar banorët në qendër të fshatit, duke i ndarë burrat nga gratë. Më pas, në mënyrë çnjerëzore, i kishin ekzekutuar mbi 80 civilë, mes tyre burra, gra dhe fëmijë. Të rënët në këtë masakër janë përkujtuar nga drejtuesit e shtetit dhe familjarët. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pasi ka bërë homazhe, ka theksuar se në Lybeniq janë vrarë dhe masakruar gra shtatzëna, foshnja në barkun e nënës dhe të moshuar. Ajo ka thënë se në këtë vend është shpërfaqur në mënyrë më mizore qëllimi i regjimit gjencidal serb. E para e vendit

ka thënë se qëllimi i Serbisë ishte që ta shfaroste popullin shqiptar. "Këtu u vranë e u masakruan edhe gratë shtatzëna, këtu u vranë edhe foshnjat në barkun e nënës e këtu u vranë edhe të moshuarit që nuk mund të lëviznin. Këtu u shpërfaq në mënyrë më mizore qëllimi i regjimit gjencidal serb. Qëllimi ishte që ta shfaroste popullin shqiptar nga faqja e dheut", ka thënë Osmani. Edhe kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe te varrezat e të vrarëve nga forcat e armatosura të Serbisë në Lybeniq të Pejës. Kurti ka thënë se Serbia vazhdon të refuzojë të ballafaqohet me të kaluarën e errët. "Përkundër dokumentimit qysh më 1999 nga Human Rights Watch, si dhe dëshmitarëve, Serbia ka zvarritur dhe mjegulluar një proces gjyqësor të nisur atje. Shteti gjencidal i Serbisë vazhdon të refuzojë të ballafaqohet me të kaluarën e errët, ndërsa është shndërruar në tokë të varrezave masive dhe



strehë e kriminelëve të luftës", ka thënë Kurti.

Të rënët në Lybeniq dhe zonës përreth tij janë përkujtuar edhe nga ish-komandanti i UÇK-së në Dukagjin, Ramush

Haradinaj. "Lybeniqi u masakrua më 25 maj 1998, ndërsa java e parë e prillit 1999 ishte kobshme për këtë fshat dhe zonën përreth. Shteti serb ekzekutoi mbi njëqind

shqiptarë të paarmatosur nga Lybeniqi, Buçani, Rashiqi, Loxha, Kosuriqi dhe Prilepi. Sot ndamë dhimbjen me familjarët si dhe zbuluam pllakën përkujtimore në shtëpinë e Ahmet Ukshinajt, të cilit pata nderin t'i ndaj dekoratën 'Me Besim në Zot, At dhe e Shtet' për angazhimin në çështjen kombëtare. Në vitet '90 kulla e tij ka qenë një prej bazave më të sigurta dhe më të rëndësishme të UÇK-së, çerdhe e shumë luftëtarëve të orëve të para. Me përlule kujtojmë edhe martirizimin e dhjetëra vëllezërve e motrave tona në Gjakovë, familjen e Januz Canës që u shua pa pasardhës, si dhe të rënët në shtëpinë e familjes Vejsa dhe në pjesë të tjera të qytetit. Asnjëherë nuk do t'i harrojmë njerëzit tanë, që me jetët e tyre u bënë mburojë e kësaj toke. Sot e për mot, përlulemi me respekt para sakrificës së të rënëve për liri", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## REKOMANDOHET SUSPENDIMI I POLICIT NË RROBA CIVILE, U PËRFSHI NË NJË RRAHJE NË PRISHTINË



PRISHTINË, 1 PRILL - Një zyrtar policor është arrestuar pas një incidenti që ka ndodhur në Prishtinë, ku dyshohet se i ai është përfshirë në një rrahje, ka njoftuar Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). Sipas njoftimit, rasti fillimisht ishte raportuar në Policinë e Kosovës si "rrahje në progres" në rrugën "Dervish Qollaku", ku ishin përfshirë disa persona dhe ndër ta dyshohej edhe një zyrtar policor. "Hetuesit e IPK-së janë njoftuar nga Policia e Kosovës për një incident në Prishtinë pas mesnatës ku dyshohej se ishte përfshirë një zyrtar policor jashtë detyrës

zyrtare", ka njoftuar IPK-ja. Pas pranimit të informacionit, hetuesit e IPK-së kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë ndërmarrë veprime hetimore. "Pas ndërmarrjes së disa veprimeve hetimore është arrestuar zyrtari policor (jashtë detyrës zyrtare dhe në rroba civile) me dyshimin se ka kryer veprën penale 'Lëndim i rëndë trupor' të cilit me vendim të Prokurorisë Themelore në Prishtinë i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë", ka njoftuar IPK-ja. IPK-ja ka rekomanduar suspendimin e përkohshëm të

zyrtarit policor. "IPK-ja ka rekomanduar edhe suspendimin e përkohshëm ndaj zyrtarit në fjalë me qëllim të mos-ndikimit në procesin hetimor dhe garantimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së hetimeve", është thënë në këtë njoftim. Sipas IPK-së, hetimet për këtë rast do të vazhdojnë në koordinim me prokurorin kompetent. "Hetuesit e IPK-së në konsultim të vazhdueshëm me prokurorin përgjegjës pritet të ndërmarrin edhe veprime të tjera hetimore lidhur me këtë rast për të sqaruar rrethanat e këtij incidenti", ka njoftuar IPK-ja.

## Ekstradohet nga Zvicra një i dyshuar për mashtrim

PRISHTINË, 1 PRILL - Policia e Kosovës ka njoftuar për ekstradimin e një shtetasi të Kosovës të dyshuar për mashtrim, i cili ishte kërkohej ndërkombëtarisht. Sipas njoftimit, njësitet e Drejtorisë për

Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në koordinim me institucionet relevante vendore dhe ato të drejtësisë, kanë realizuar ekstradimin e personit me inicialet B. Z. nga Zvicra në Kosovë. "I dyshuari ishte

arrestuar nga autoritetet zvicerane pasi i njëjti kërkohej përmes Interpolit me letër rreshtim ndërkombëtar lëshuar nga institucionet e drejtësisë së Kosovës, për veprën penale 'Mashtrim' dhe se i njëjti iu ishte

shmangur drejtësisë", ka njoftuar policia. Sipas njoftimit, ekstradimi është realizuar në bazë të ligjeve në fuqi dhe falë bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të Kosovës dhe Zvicrës.



## Hasani: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese ngushtuan hapësirën e manovrimit politik

PRISHTINË, 1 PRILL - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka thënë se vendimet e Kushtetueses kanë ngushtuar hapësirën e manovrimit politik. "Besoj (vendimet e Kushtetueses) se e kanë ngushtuar hapësirën e veprimit të politikës. Çdoherë, çdo aktgjykim, prej rastit të Sejdiut, rastit Pacolli, rastit të kryeprokurorit të Shtetit, rastit të kryetarit të Kuvendit - rasti VLAN 1 dhe 2, që i themi ne më 2014, rasti Hoti dhe të gjitha rastet e tjera, e kanë ngushtuar hapësirën për manovrim politik. Dhe, siç e thashë, i ka juridifikuar proceset, u ka vënë koperturë kushtetuese

proceseve të pastra kushtetuese", ka thënë Hasani për "Betimi për Drejtësi". Sipas tij, ka pasur raste të vendimeve të Kushtetueses që kanë qenë lëshim absurd profesional, duke pasur parasysh kontekstin politik. "Një kohë, ju e dini që të gjithë ne kemi thënë që mirë është, njerëzit me precedentë penalë – aktakuzë, mos të hyjnë në procese politike, por kjo nuk është respektuar", ka thënë Hasani.

Rasti i ish-deputetit Etem Arifi, ka thënë Hasani, ka qenë profesionalisht problematik. "Çdokush që është dënuar në tre vitet e fundit për çfarëdo dënimi, nuk ka pasur kuptim të

ndodhë dënimi që s'ka lidhje me atë. Për shembull, në trafik – komunikacion, pra ndonjë rast që është totalisht jashtë vullnetit të njeriut. Dhe çfarë ndodhi? E ndërruan ligjin, me sa e di unë, dhe si e ndërron ligjin, e ke ndërruar edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Absurdi është ky", ka thënë Hasani.

Ai ka thënë se garancitë kushtetuese në kapitullin 2 dhe 3 nuk duhet të preken dhe duhet pasur shumë kujdes. "Një e metë, një gabim që ka qenë, është se gjykata duhet të ketë kujdes kur e ndërron standardin, precedentin që i themi ne. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë ta ndërrojë precedentin, por



ndërrimi i precedentit mund të bëhet vetëm mbi bazën e arsyeve të forta", ka thënë Hasani. Ndërrimi i standardit kushtetues, Hasani ka thënë se bëhet vetëm kur ka arsye të

fortë, derisa ka theksuar se ndërrimi i precedentit nga Kushtetuesja, në disa raste, nuk ka qenë i arsyeshëm, pasi nuk ka pasur brumë të mjaftueshëm.

## DEPUTETËT U FRIKËSOHEN ZGJEDHJEVE TË REJA, THEKSOJNË NEVOJËN E STABILITETIT INSTITUCIONAL

PRISHTINË, 1 PRILL - Stabilitet institucional përmes zgjedhjes së presidentit është kërkuar në Komisionin Parlamentar për Integrime Evropiane para thirrjes për diskutim të ambasadorëve të vendeve të Bashkimit Evropian për rrugën evropiane të Kosovës.

Në diskutimin që ky komision ka bërë të mërkurën për Planin e Punës, është theksuar se ka shqetësim të deputetëve se sa do të jetë jetëgjatësia e legjislaturës së dhjetë pas mospajtimeve të partive politike për ta zgjedhur presidentin. Pasi kanë mbetur edhe 27 ditë afat kushtetues për ta zgjedhur të parin e vendit, deputetët, anëtarë të këtij komisioni, kanë thënë se shpresojnë që të gjendet një zgjidhje për kryetarin e shtetit. Kryetarja e komisionit, njëherësh deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka shprehur skepticism që ambasadorët do



t'i përgjigjen pozitivisht ftesës së komisionit për diskutim pasi, sipas saj, çështja e stabilitetit institucional është kusht për secilin hap të integritimit në BE. "Ambasadorët i thërësimi pasi ta zgjedhim presidentin. Për besë nuk besoj as që na vizitojnë. Çështja e stabilitetit institucional është gati kusht për secilin hap në integrimin evropian. Unë po shpresoj shumë që do të arrijmë ta

zgjedhim. Është prioritet mbi prioritetet, pasi ne kur e planifikojmë punën, asnjëri nuk po jemi të sigurt, pasi e dimë ngërçin që ka ndodhur muajin e kaluar dhe po e dimë që Kuvendi i Kosovës s'ka qenë aktiv prej dhjetorit të vitit 2024. Ky është një lloj shqetësimi, pasi nëse s'kemi hapa konkretë, sa do të jetë jetëgjatësia e kësaj legjislature?", ka thënë Bajrami. Ndërkaq deputetja e partisë në

pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, Liza Gashi, ka thënë se ata janë të hapur për ta zgjedhur presidentin. "Ne jemi të hapur për ta zgjedhur presidentin. Unë po gëzohem që kjo është prioritet", ka thënë Gashi.

Duke iu kundërpërgjigjur deputetes së mazhorancës, Hykmete Bajrami, ka thënë se shpreson që të gjithë deputetët të bëjnë një zgjidhje për presidentin, më pas ajo e ka ndryshuar deklarinimin e saj duke iu drejtuar deputetes së LV-së me fjalët: "Po shpresoj që do të mund të bëni ndonjë zgjidhje". Ajo ka folur edhe për mbarëvajtjen e punës së këtij komisioni, ku ka thënë se është e nevojshme që kryenegociatori i Kosovës për integrim në BE, Jeton Zulfaj, të raportojë në komision. "Çaktimi i ministrave në raportim apo vizitat në ministri të ndodhin pas takimit me kryenegociatorin, ku ne prej tij do të kërkonim agjendën e

reformave rreth Planit të Rritjes dhe zbatimit të të gjitha kushteve. Të shohim pastaj se cila prej ministrave ka bërë përparim ose ka ndonjë ngecje në realizimin e programit të reformave", ka thënë Bajrami.

Kërkesë të ngjashme ka parashtruar edhe deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, e cila ka thënë se është e nevojshme të ketë transparencë në procesin integruar. "Ajo çfarë është me rëndësi, kryenegociatori duhet me qenë transparent dhe të vijë para komisionit të raportojë, ndoshta edhe para fillimit të negociatave, dhe të bëhet me dije se cila është agjenda e diskutimit apo e ndonjë takimi që mbahet, qoftë bilateral apo trilateral në Bruksel", ka thënë Kadrijaj. Pas këtij diskutimi, anëtarët e Komisionit Parlamentar për Integrime Evropiane kanë miratuar agjendën e punës së këtij komisioni.

## Bajrami: Kurti, fajtori kryesor nëse vendi shkon në zgjedhje

PRISHTINË, 1 PRILL - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, e ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti për mungesë gatishmërie për zgjedhjen e presidentit të ri. Sipas saj, Kurti është duke synuar ta dërgojë vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme. Deputetja Bajrami ka thënë se Kurti ka mundur ta zgjedhë presidentin më herët, duke arritur marrëveshje me partitë opozitare. "Gjatë këtyre tetë ditëve nuk e kemi parë as tentativën më të vogël. Kjo tregon se që nga fillimi i kësaj legjislature, Kurti nuk e ka në plan të bëjë zgjedhjen e presidentit dhe nuk e ka në plan të kontribuojë në stabilitetin

institucional të Republikës së Kosovës. Këtë e kemi parë në votimin shumë urgjent të buxhetit. Këta dëshirojnë ta kenë buxhetin në mënyrë që të mund t'i shpërndajnë taksat e qytetarëve për efekte elektorale por, faktikisht, nuk e kanë në plan ta zgjedhin presidentin. Sikur të dëshironin një gjë të tillë, do ta bënin tashmë prej kohësh. Ju e dini se, pas disa takimeve që ka pasur me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe atë të PDK-së, Bedri Hamza, në mënyrë krejtësisht të njëanshme janë propozuar dy kandidatë nga LV-ja, duke u mundur t'i shantazhojnë partitë opozitare,

të cilën nuk e kemi pranuar", ka thënë Bajrami për "RTV21". Deputetja Bajrami ka thënë se nëse kalon afati kushtetues 34-ditor për zgjedhjen e presidentit, atëherë fajtori kryesor është kryeministri Kurti për mosgatishmëri për të arritur marrëveshje politike. "Numri i ditëve është i kufizuar dhe kjo është një çështje e komplikuar, e cila assesi nuk zgjidhet nga partitë opozitare. Nëse ne mbetemi në këtë bllokadë dhe nëse harxhohet afati kohor që na e ka dhënë Gjykata Kushtetuese, secili qytetar duhet ta dijë se fajtori kryesor që përsëri po e dërgon vendin në një proces zgjedhor



është zoti Kurti dhe LV-ja", është shprehur Bajrami, duke shtuar se LDK-ja nuk do ta votojë asnjë kandidat nga LV-ja për president. "Nuk kemi votë për kandidatët e LV-së për president. I patëm dy kandidatë

nga LV-ja dhe nuk ka ndodhur asgjë që ne ta ndryshojmë qëndrimin. Jemi kundër ndarjes së të gjitha pozitave. Presidenti duhet të jetë figurë unifikuese", ka deklaruar Bajrami.

## AKB-ja: Paga e 13 vetëm për sektorin publik është e papranueshme dhe diskriminuose

PRISHTINË, 1 PRILL - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e pagës së 13 vetëm për sektorin publik e ka cilësuar diskriminues dhe të padrejtë ndaj sektorit privat. Sipas tij, ky vendim krijon ndarje të rrezikshme në shoqëri, duke

favorizuar një kategori në kurriz të tjetrës, ndonëse të gjithë qytetarët dhe bizneset kontribuojnë në mbushjen e buxhetit të shtetit. "Sektori privat, i cili është bartësi kryesor i zhvillimit ekonomik, punëson shumicën e qytetarëve dhe siguron të hyrat kryesore për shtetin, po

inorohet në mënyrë të pajustificueshme. AKB-ja vlerëson se paga e 13 për sektorin publik nuk është meritë, por shpërblim selektiv dhe politik, i cili cenon parimet e barazisë dhe konkurrencës së ndershme", ka thënë Shahini. Shahini ka kërkuar nga qeveria ta ndalë këtë qasje, siç thotë ai,

diskriminuose ndaj sektorit privat, t'i subvencionojë edhe punëtorët e sektorit privat dhe kategoritë sociale dhe të garantojë barazi për të gjithë kontribuuesit. Në të kundërtën, sipas tij, vendime të tilla do ta dëmtojnë seriozisht klimën e biznesit dhe besimin në institucionet shtetërore.



## INSTITUTI GAP: RITJA E PAGAVE NUK ËSHTË SHOQËRUAR ME RITJE TË DINAMIKËS SË PUNËS NË KUVENDET KOMUNALE

Instituti GAP ka publikuar të mërkurën analizën me titull: "A ndikoi rritja e pagave në përmirësimin e dinamikës së punës të Kuvendeve Komunale?". Në këtë analizë është thënë se Ligji për Pagat në sektorin publik, i zbatuar nga viti 2023, ka ndryshuar ndjeshëm mënyrën e kompensimit financiar në administratën publike dhe në mënyrë të veçantë, në pushtetin lokal. Në kontekstin e asamblistëve komunalë, kjo reformë sipas GAP-it ka rezultuar në rritje të dukshme të nivelit të kompensimit. Para hyrjes në fuqi të Ligjit të pagave, kompensimi i asamblistëve ishte 150 euro si pagë bazë dhe 50 euro shtesë për çdo seancë të mbajtur, pa dallim në mes të komunave të mëdha, të mesme

A ndikoi rritja e pagave në përmirësimin e dinamikës së punës të Kuvendeve Komunale?



dhe të vogla, pra me trajtim uniform.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, në kryeqytet, koeficienti 6 prodhon një pagë prej 660 euro, ndërsa në komunat e tjera koeficientet luhaten nga 5.3 deri në 5.9, duke krijuar shkallëzime sipas komunës, ku paga më e ulët e një asamblisti/eje në një komunë të vogël arrin 583 euro. Sipas Institutit GAP, prishmëria se rritja e pagave do të ndikojë në

rritje të motivimit është e arsyeshme, pasi kompensimi financiar konsiderohet një nga faktorët më të rëndësishëm që mund të ndikojë në cilësinë dhe nivelin e përpjekjeve.

Kjo rëndësi rritet tek asamblistët komunalë, sepse kompensimi i pamjaftueshëm deri në fund të vitit 2022, shpesh i ka shtyrë të zgjedhurit lokalë të mbajnë angazhime të tjera për të siguruar të ardhura për mbulimin e shpenzimeve. Në këtë kuptim, rritja e pagave e bën të pritshëm përqendrimin më të madh në angazhimin institucional. Por, gjetjet e GAP-it kanë sugjeruar se kjo rritje e pagave nuk është shoqëruar me rritje të dinamikës së punës në kuvendet komunale. Pas rritjes së pagave nga fillimi i vitit 2023 e tutje, në disa tregues që masin performancën e

kuvendeve komunale ka pasur rritje të kufizuar ose minimale, ndërsa në shumicën e treguesve të tjerë vërehet rënie. Numri i mbledhjeve të kuvendeve komunale në shtatë komuna ishte 81 në vitin 2022, 91 në vitin 2023, ndërsa ka rënë në 85 në vitin 2024. Kjo nënkupton se periudha e parë pas rritjes (2023) shënon një rritje të numrit të mbledhjeve krahasuar me vitin bazë, por ky trend nuk konsolidohet në vitin pasues (2024), ku numri i mbledhjeve është i ngjashëm me ato të vitit 2022. Edhe kohëzgjatja totale e mbledhjeve jep rezultat negativ. Koha e kaluar nga kuvendet komunale në shtatë komunat në seanca në vitin 2022 ishte 285 orë, në vitin 2023 rreth 286 orë, ndërsa në vitin 2024 ka rënë në 271 orë. Pra, rritja në 2023 është

minimale, ndërsa në 2024 ka rënie të dukshme të kohës së kaluar në mbledhje. Ndërkohë, produktiviteti normativ nuk dëshmon rritje pas rritjes së pagave, përkundrazi shfaqet rënie: në vitin 2022 janë miratuar 26 rregullore dhe 540 vendime, në vitin 2023 janë miratuar 35 rregullore dhe 477 vendime, ndërsa në vitin 2024 vetëm 10 rregullore dhe 442 vendime. Është e rëndësishme të theksohet se këta janë indikatorë sasiorë që nuk matin drejtpërdrejt cilësinë e debatit apo ndikimin e vendimeve. Megjithatë, si tregues të krahasueshmëri ndër vite, ata ofrojnë një pasqyrë të vlefshme mbi ritmin dhe intensitetin e punës së kuvendeve komunale, veçanërisht në raport me ndryshimet në kompensim financiar.

## KOMISIONI PËR BUXHET MIRATON MARRËVESHJEN E KREDISË PËR SEKTORIN FINANCIAR, PDK-JA VOTON KUNDËR

PRISHTINË, 1 PRILL - Komisioni për Buxhet ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, që synon zhvillimin e sektorit financiar në vend. Projektligji u miratua me 6 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, ndërsa kundër votuan deputetët e PDK-së, Kujtim Gashi dhe Mërgim Lushtaku. Ministri i Financave, Hekuran Murati, theksoi se kjo marrëveshje paraqet një mundësi të rëndësishme për forcimin e stabilitetit financiar

dhe zhvillimin e mekanizmave të rinj mbështetës për ekonominë. Sipas tij, marrëveshja përfshin katër komponentë kryesorë: themelimin dhe financimin fillestar të Bankës Zhvillimore, rritjen e kapitalit në Fondin për Garanci Kreditore për të lehtësuar qasjen në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, mbështetjen e Fondit për Sigurimin e Depozitave me ndryshime ligjore dhe rritje të kufirit të sigurimit nga 5 mijë në 10 mijë euro, si dhe integrimin e Kosovës në sistemin SERA, që pritet të ulë ndjeshëm kostot e transfereve



financiare.

Vlera totale e marrëveshjes është 49.3 milionë euro, ku 35 milionë euro i përkasin komponentës kryesore me periudhë grejs prej 5 vjetësh dhe afat kthimi deri në 25 vjet, ndërsa 14 milionë euro janë të ndara për komponentën tjetër me kushte më afatshkurtra kthimi. Megjithatë, marrëveshja

u kundërshtua nga opozita.

Deputeti i PDK-së, Kujtim Gashi, deklaroi se Kosova nuk ka nevojë të marrë një kredi të tillë për asistencë teknike, duke theksuar se buxheti i vendit është i mjaftueshëm për të përballuar këto projekte pa u futur në borxh shtesë.

Në anën tjetër, deputeti i LDK-së, Besian Mustafa, kërkoi sqarime shtesë për dallimin ndërmjet Bankës Zhvillimore dhe Fondit për Garanci Kreditore. Në përgjigje, ministri Murati shpjegoi se Banka Zhvillimore synon t'i plotësojë boshllëqet në tregun financiar, sidomos në rastet kur bankat komerciale

kanë kufizime në ekspozim ose mungesë likuiditeti, duke ofruar instrumente të reja financiare dhe mbështetje më të drejtpërdrejtë për bizneset. Gjatë mbledhjes, Mustafa ngriti edhe çështjen e rritjes së çmimeve të produkteve bazë, përfshirë energjinë dhe naftën, duke kërkuar raportim nga Ministria e Financave për masat konkrete që po ndërmerren për t'i mbrojtur qytetarët nga rritja e kostos së jetesës. Kryetari i Komisionit për Buxhet, Enver Haliti, bëri me dije se për këtë çështje tashmë është thirrur një seancë e jashtëzakonshme që pritet të mbahet së shpejti.

## Azemi: 87 për qind e njehsorëve të rrymës matin kohën gabimisht

PRISHTINË, 1 PRILL - Në një kohë kur çmimi i energjisë elektrike vazhdon ta rëndojë buxhetin e qytetarëve dhe bizneseve në Kosovë, dyshimet për saktësinë e njehsorëve elektrikë kanë ngritur shqetësime serioze në opinionin publik. Visar Azemi nga LDK-ja ka adresuar akuza të forta lidhur me funksionimin e njehsorëve dhe ndikimin në faturimin e energjisë. Sipas tij, një hulumtim i realizuar mbi qindra mostra tregon probleme të theksuara në

matjen e kohës. "I kam hulumtuar 884 mostra... 87 për qind të tyre e masin kohën gabimisht dhe ky ka qenë alarmi i parë", ka deklaruar ai.

Azemi ka shpjeguar se problemi lidhet drejtpërdrejt me tarifën e energjisë, pasi qytetarët besojnë se po shfrytëzojnë energji më të lirë gjatë natës, ndërsa në realitet mund të paguajnë më shtrenjtë. "Kur ti ke menduar që je duke e shfrytëzuar energjinë më të lirë, ti realisht je duke e shfrytëzuar

energjinë më të shtrenjtë, sepse njehsori ka matë gabimisht. Mua më është dukur se është një skemë skandaloze për t'i faturuar qytetarët jashtëligjshëm", ka deklaruar për "Telegrafin".

Pas publikimit të shqetësimeve për njehsorët e rrymës, Azemi ka thënë se ka pasur reagim të madh nga qytetarët, me mijëra ankesa dhe dëshmi. Ai ka kritikuar edhe reagimin e kompanisë KEDS, e cila, sipas tij, e ka minimizuar problemin duke

e quajtur "gabim teknik". Në të njëjtën kohë, Azemi ka hedhur përgjegjësinë edhe mbi institucionet shtetërore për mungesë të mbikëqyrjes. "Institucionet, qeveria, ministria, kanë dështuar në mbikëqyrje dhe në mbrojtjen e qytetarëve", ka thënë Azemi.

Më tutje, Azemi ka bërë me dije se ka kërkuar hetim nga Zyra e Rregullatorit për Energi dhe ka paralajmëruar veprime të mëtejshme ligjore. Ai ka thënë se



çështja duhet të trajtohet edhe në Kuvend dhe nuk duhet të mbetet vetëm në debat publik. Përtej çështjes së njehsorëve, Azemi ka vlerësuar se sektori i energjisë në Kosovë po përballet me probleme strukturore dhe mungesë investimesh.

# TRUMP THOTË SE PO NEGOCION ME LIDERËT IRANIANË, EDHE PSE TEHERANI E MOHON



Tensionet mes SHBA-së dhe Iranit po thellohen në një situatë kontradiktore, ku deklaratat për negociatë të drejtpërdrejta përplasen me mohimet nga Teherani, ndërsa në terren konfliktet po përshkallëzohen me sulme ndaj infrastrukturës energjetike dhe kërcënime për një përplasje më të gjerë rajonale.

Tensionet mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit kanë hyrë në një fazë të re, ku deklaratat për negociatë të drejtpërdrejta përplasen me mohimet nga Teherani, ndërsa në terren situata po përshkallëzohet me sulme ndaj infrastrukturës energjetike dhe kërcënime për një konflikt edhe më të gjerë. Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se SHBA është në bisedime direkte me liderët iranianë për t'i dhënë fund luftës, duke përmendur edhe kontakte me figura të rëndësishme si kryetari i parlamentit iranian, Mohammad Ghalibaf. Sipas tij, përparimi është i shpejtë dhe një marrëveshje mund të arrihet brenda pak ditësh.

Megjithatë, kjo narrativë bie ndesh me qëndrimin zyrtar të Iranit. Autoritetet në Teheran kanë mohuar kategorikisht çdo negociatë direkte, duke theksuar se komunikimi ka

ndodhur vetëm përmes ndërmjetësve dhe duke i cilësuar kërkesat amerikane si "jorealiste dhe irracionale".

## Një marrëveshje në horizont apo luftë në prag?

Sipas Trump, Irani ka pranuar shumicën e kërkesave të SHBA-së, të cilat përfshijnë ndalimin e programit të pasurimit të uranimit, dorëzimin e materialeve të pasuruara dhe kufizime të forta mbi raketat balistike. Ai ka deklaruar se negociatat janë "shumë pozitive", duke sugjeruar se fundi i konfliktit është afër.

## Por realiteti në terren tregon një histori tjetër.

Sulmet reciproke ndaj infrastrukturës energjetike kanë shënuar një përshkallëzim të ri. Irani goditi rafinerinë më të

madhe të naftës në Haifa, ndërsa vetë Teherani u përball me ndërprerje të energjisë pas sulmeve ndaj rrjetit elektrik. Kjo situatë e dyfishtë, negociatë në fjalë dhe përshkallëzim në terren, tregon se konflikti është larg stabilizimit.

## Ngushtica e Hormuzit: pika kyçe e përplasjes

Një nga çështjet më kritike mbetet Ngushtica e Hormuzit, një arterie jetike për tregtinë globale të naftës. Trump ka deklaruar se SHBA synon të marrë kontrollin e kësaj rruge strategjike dhe të sigurojë lirinë e lundrimit.

Ai madje ka pretenduar se Irani ka lejuar kalimin e disa anijeve si "gjest vullneti të mirë". Por nga ana tjetër, mediat shtetërore iraniane e kanë ironizuar këtë pretendim, duke thënë se kalimi është lejuar vetëm për disa tankerë kinezë.

Nëse Hormuzi mbetet i bllokuar, pasojat ekonomike globale do të jenë të menjëhershme, me rritje të çmimeve të energjisë dhe destabilizim të tregjeve.

## Kush e ka avantazhin?

Një element interesant në këtë

krizë është perceptimi i forcës. Sipas analizave të inteligjencës amerikane, Irani beson se ka epërsinë dhe nuk është i prirur të dorëzohet nën presion.

Nga ana tjetër, administrata amerikane argumenton se Irani është dobësuar ndjeshëm nga goditjet ushtarake dhe për këtë arsye kërkon marrëveshje. Kjo përplasje perceptimesh është thelbësore: kur të dyja palët besojnë se janë në avantazh, rreziku i përshkallëzimit rritet ndjeshëm.

## Kriza e lidershipit në Iran

Situata është komplikuar edhe më shumë nga paqartësia rreth lidershipit iranian. Sipas deklaratave amerikane, shumë figura kyçe janë eliminuar gjatë konfliktit, përfshirë liderë ushtarakë dhe politikë. Pas vrasjes së liderit suprem Ali Khamenei, në krye është vendosur Mojtaba Khamenei, por gjendja e tij mbetet e paqartë, me raportime se mund të jetë i plagosur rëndë. Kjo pasiguri e brendshme mund të ndikojë në aftësinë e Iranit për të negociuar ose për të marrë vendime strategjike.

## Diplomacia ndërkombëtare në sfond

Ndërkohë, disa vende si Pakistani, Turqia dhe Egjipti po përpiqen të ndërmjetësojnë mes palëve. Takime të nivelit të lartë janë zhvilluar në Islamabad, por deri tani nuk ka shenja konkrete për një marrëveshje të afërt. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka pranuar se komunikimi ekziston, por kryesisht përmes ndërmjetësve, duke zbutur disi deklaratat e Trump për bisedime direkte.

## Një ekuilibër i brishtë

Ajo që po shohim është një situatë paradoksale: nga njëra anë retorikë për marrëveshje dhe progres, nga ana tjetër kërcënime për shkatërrim total të infrastrukturës iraniane nëse nuk arrihet një zgjidhje. Trump ka paralajmëruar se nëse nuk hapet Hormuzi dhe nuk arrihet marrëveshje, SHBA mund të godasë objektiva kyçe si termocentrale, puse naftë dhe terminale strategjike. Në këtë kontekst, çdo zhvillim mund të jetë vendimtar, ose drejt një marrëveshjeje historike, ose drejt një konflikti shumë më të gjerë në Lindjen e Mesme. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Torino interesohet për Ramadanin

**TORINO, 1 PRILL** - Mesfushori Ylber Ramadani mund të largohet nga skuadra e Lecces, por jo edhe nga Seria A e Italisë. Është bërë me dije se Ramadani është pranë një aventure të re, pasi Ramadani ka tërhequr interesimin e

skuadrës së Torinos. Ramadani është duke luajtur sezonin e tretë në elitën e futbollit italian, duke u shndërruar në një lojtar kyç të Lecces në repartin e mesfushës. Megjithatë, është thënë se, sipas të gjitha gjasave, ky sezon

mund të jetë i fundit për 30-vjeçarin te Lecce, ekip që ka 1 gol të shënuar në 29 ndeshje kampionale deri më tani. Është trajneri i Torinos, Roberto D'Aversa, ai që është duke insistuar për Ramadaniin pasi e njih mirë mesfushorin e

Kombëtares së Shqipërisë, me të cilin ka punuar më përpara. Për ta finalizuar transferimin e Ramadaniit këtë verë, Torino duhet të paguajë rreth 2.5 milionë euro pasi ka kontratë me Leccen deri në verën e vitit të ardhshëm.



## ADEMI, MESAZH SHTETIT: STADIUMI ËSHTË URGJENCË KOMBËTARE



**PRISHTINË, 1 PRILL** - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka deklaruar se gjëja e vetme që i nevojitet Kosovës urgjentisht është ndërtimi i një stadiumi me kapacitet sipas standardeve të FIFA-s. Ademi ka bërë me dije se interesimi për përcjelljen e ndeshjes Kosovë - Turqi ka qenë i jashtëzakonshëm, pasi rreth 400 mijë kërkesa janë

parashtruar për blerjen e biletave. "Vetëm një gjë na duhet me çdo kusht dhe me shpejtësi, siç thonë, të 'dritës së syrit': një stadium nacional apo një stadium, qysh do ta quajmë, i cili i plotëson kriteret dhe kushtet, sepse jemi shumë të ngushtuar nga popullata jonë, nga tifozët tanë, që nuk po mund t'u bëjmë vend në stadiumin 'Fadil Vokrri'. Besoni, kanë qenë më shumë se 300

mijë apo rreth 400 mijë kërkesa në platformë për një biletë. Kur i ke parasysh që i heqin disa bileta që janë për evakuim, disa që i takojnë kundërshtarit, ne mbesim diku më pak se 10 mijë bileta për shitje", ka thënë Ademi. Kujtojmë se Kosova ka pësuar humbje nga Kombëtarja e Turqisë, me rezultat minimal 0-1, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në finalen e "play-off"-it për Kupën e Botës.

## PLOTËSOHET TABELA, KËTO JANË KOMBËTARET QË DO TË MARRIN PJESË NË KUPËN E BOTËS

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Tashmë janë përcaktuar katër skuadrat që kanë siguruar biletën për në Kupën e Botës 2026 e cila do të zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada, përmes fazës "play-off". Kombëtarja e Kosovës nuk ka arritur ta realizojë ëndrrën e madhe, pasi është mposhtur me rezultat minimal 1-0 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Befasia më e madhe është regjistruar në Zenicë, ku Bosnja-Hercegovina ka eliminuar Italinë pas ekzekutimit të penalltive. Takimi ka përfunduar 1-1 pas 120 minutave lojë, ndërsa "azzurrët" kanë mbetur me një lojtar më pak që nga minuta e 41-të, pasi Alessandro Bastoni



është ndëshkuar me karton të kuq. Në fund, boshnjakët janë treguar më të saktë nga pika e bardhë. Me penallti është

vendosur edhe sfida mes Çekisë dhe Danimarkës, pasi ndeshja ka përfunduar 2-2 pas kohës shtesë, ndërsa çekët kanë

triumfuar 3-1 në penallti. Ndërsa Suedia ka arritur fitore të bukur ndaj Polonisë me rezultat 3-1. Kupa e Botës do të nisë më

11 qershor. Ai organizohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksika dhe Kanada.

### GRUPET PËR KUPËN E BOTËS:

Grupi A: Çekia, Meksika, Afrika e Jugut dhe Koreja e Jugut  
Grupi B: Kanadaja, Bosnjë-Hercegovina, Katari dhe Zvicra  
Grupi C: Brazili, Haiti, Maroku dhe Skocia  
Grupi D: Australia, Paraguai, Turqia dhe ShBA  
Grupi E: Curacao, Ekuadori, Gjermania dhe Bregu i Fildishtë  
Grupi F: Holanda, Japonia, Suedia dhe Tunizia  
Grupi G: Belgjika, Egjipti, Irani dhe Zelanda e Re  
Grupi H: Kepi i Gjelbër, Arabia Saudite, Spanja dhe Uruguai  
Grupi I: Franca, Norvegjia, Senegali dhe Iraku  
Grupi J: Algjeria, Argjentina, Austria dhe Jordania  
Grupi K: Kolumbia, Xhamajka, Portugalia dhe Uzbekistani  
Grupi L: Kroacia, Anglia, Gana dhe Panamaja

## Liverpooli synon transferimin e tre yjeve të Juventusit në verë

**LIVERPOOL, 1 PRILL** - Liverpooli është raportuar se po ndjek tre nga lojtarët kryesorë të Juventusit përpara afatit kalimtar të verës, me Pierre Kalulu, Francisco Conceicao dhe Khephren Thuram që të gjithë duken si objektiva. Interesi për Kalulu është shfaqur javën e kaluar, me raportimet në Itali që gjithashtu lidhin Manchester Unitedin me mbrojtësin francez. Conceicao është përmendur gjithashtu si

një zëvendësim i mundshëm afatgjatë për Mohamed Salah, megjithëse anësori portugez kohët e fundit ka deklaruar se është i lumtur në Torino. Liverpooli është thënë se ka bërë kontaktin fillestar, por çdo marrëveshje pritet të jetë e vështirë. Sipas "Gazzetta dello Sport", interesi i Liverpoolit për yjet e skuadrës së Juventusit po rritet, me klubin që potencialisht do të detyrohet të shesë lojtarë nëse

nuk arrin të sigurojë një vend në katër vendet e para dhe ta humbasë kualifikimin në Ligën e Kampionëve. Conceicao, i cili i është bashkuar Juventusit në një marrëveshje me vlerë deri në 32 milionë euro, mund të shitet për rreth 50 milionë euro, duke gjeneruar një fitim të konsiderueshëm për ekipin italian. Kalulu vlerësohet rreth 30 milionë euro, me Juventusin që është thënë se është i gatshëm të marrë në

konsideratë vetëm një ofertë të madhe pavarësisht prej kërkesave nga disa klube të Ligës Premierë. Ndërkohë, Thuram është bërë një nga lojtarët më me ndikim të Juventusit dhe është duke tërhequr gjithashtu interesim nga Liverpooli dhe Manchester Unitedi. Mesfushori mund të jetë i disponueshëm për rreth 40 milionë euro. Pozicioni përfundimtar i Juventusit në ligë ka të ngjarë të jetë vendimtar,



me kualifikimin në Ligën e Kampionëve që zvogëlon nevojën për shitje, ndërsa mungesa e një mundësie mund të detyrojë një ndryshim të madh gjatë verës.

# DO JETË NJË BOTËROR SPEKTAKOLAR. TRE TË MËDHATË QË FRIKËSOJNË BOTËN



Janë tre dhe i bëjnë të gjithë të tremben. Janë Spanja, Franca dhe Argjentina, favoritët e mëdhenj për Botërorin 2026 në Kanada-SHBA-Meksikë, jo rastësisht fitueset e tre prej katër Botërorëve të fundit. Spanja fitoi në Afrikën e Jugut në vitin 2010 me golin e Iniestës, Franca dominoi Kroacinë (4-2) në Rusi 2018, ndërsa Argjentina është kampionia në fuqi pasi mundi me penallti pikërisht Francën katër vite më parë në Katar.

Në vitin 2014 në Brazil fitoi Gjermania, e cila nis mes favoriteve, por duket një shkallë më poshtë, së bashku me Brazilin që ende nuk bind dhe Anglinë, që vjen nga dy finale europiane të humbura: e bukur, por humbëse. Të gjitha ëndërrojnë, nga Portugalia te Holanda e deri te Uruguaji. Mungon vetëm një nga tetë kombëtares që kanë ngritur kupën në gati një shekull histori: Italia. Për herë të tretë radhazi.

Pra, tre të mëdhatë: Franca, Spanja dhe Argjentina. Spanja ka një skuadër që luan “me sy mbyllur”, ndoshta futbollin më të rrjedhshëm dhe teknik, më

pak fizik, me yje si Pedri, Nico Williams dhe mbi të gjitha Lamine Yamal, i cili mund të shfaqet si trashëgimtari i vërtetë i Messit dhe Ronaldos që në Botërorin e tij të parë. Franca është më fizike dhe ka organikën më të gjerë: edhe “Franca B” e Deschamps do të ishte kualifikuar pa problem. Tani duket se po shpreh gjithmonë potencialin e saj dhe Mbappé, në Botërorin e tij të tretë, është ylli absolut.

Argjentina është solide, me përvojë, e pathyeshme dhe Messi nuk mund të mos synojë një triumf të dytë që do ta vendoste përkrah Pelés dhe Maradonës. Nuk do të kenë probleme në kualifikime, por grupet nuk janë të balancuara.

## Botërori, një turne gigant

Franca ka grupin më të vështirë, pasi përballlet me Norvegjinë e Haaland, enigma e vërtetë e turneut – historikisht një “e vogël” që është bërë e madhe – dhe Senegalin. Rregullorja parashikon që në fazën e 1/16-ve kalojnë dy të parat e secilit

prej 12 grupeve (24 skuadra gjithsej), plus 8 më të mirat e vendeve të treta. Diskutimi zhvendoset tek rruga drejt finales. Në teori, vendi i parë garanton, të paktën në fillim, një kalendar më të lehtë, por gjithçka varet nga përballjet dhe rezultatet e grupeve të tjera.

Dhe nuk është e lehtë të bëhen parashikime, sepse do të jetë një Botëror rraskapitës për shumë arsye. Së pari, për herë të parë do të marrin pjesë 48 skuadra, që do të thotë një ndeshje më shumë (nga 7 në 8) për ata që arrijnë në finale. Pastaj tre shtete pritëse, Kanada, Meksikë dhe SHBA, me udhëtime të gjata dhe ndryshime të orareve që do të ndikojnë në gjendjen fizike dhe psikologjike. Së fundi, klima, mesatarisht shumë e nxehtë dhe me orare, për arsye televizive, jo gjithmonë të favorshme, si për shembull ndeshjet në mesditë në Kaliforni.

## Brazili dhe të tjerat

Nuk është kurrë e lehtë të përjashtohet Brazili nga

pretendimet për podiumin, por Ancelotti duhet të përballlet me realitetin: një kombëtare që nga viti 2002 (Japoni-Kore) ka fituar tre Kupa Amerikash dhe tre Kupa Konfederatash (tashmë të zhdukura), jo e njëjta gjë me një Botëror. “Seleção” ka humbur edhe një miqësore me Francën, por siç thotë Tardelli: “është Ancelotti”, dhe gjithçka mbetet e mundur. Gjermania po rinovohet rreth bërthamës së Bayernit, Anglia duhet të gjejë formën më të mirë të Bellingham, por ka Kane, Kroacia vjen nga dy Botërorë të mëdhenj (e treta në 2022), Portugalia ka një CR7 që nuk dorëzohet kurrë. Kolumbia dhe Ekuadori janë “outsider”-ët e Amerikës së Jugut, ndërsa Maroku është përfaqësuesja më e fortë afrikane.

## Yjet

Messi, Lamine Yamal dhe Mbappé janë fenomenet e shpallur. Nga Julian Alvarez te Haaland, nga Rice te Olise, nga Vinicius te Dembélé, nga Vitinha te Doué... lista është shumë e

gjatë. Ka të gjitha kushtet për një turne spektakolar, si rrallëherë.

## Gjeopolitika

Ka katër debutues: Kepi i Gjelbër, Curaçao, Jordania dhe Uzbekistani, i cili, pasi siguroi kualifikimin për në Amerikë, ka marrë Cannavaron si trajner për të pasur një emër të madh në stol. Një tjetër italian është Montella me Turqinë.

Asnjëherë më parë nuk ka pasur një përfaqësim kaq të gjerë global, sepse zgjerimi në 48 skuadra ka favorizuar të gjitha kontinentet, përveç Europës që nga 12/13 është rritur në 16 kombëtare – pak në raport me nivelin e kualifikimeve.

Është e pamundur të injorohen edhe çështjet politike, me Iranin që pritet të luajë në SHBA pas zhvillimeve të fundit me Trump. Shpresojmë që politika të qëndrojë jashtë.

Starti më 11 qershor në mitikun “Azteca” të Mexico City me Meksikë-Afrikë e Jugut, ndërsa kupa do të ngrihet më 19 korrik në East Rutherford, në New Jersey. / gazzetta dello sport – bota.al

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin ‘‘Kosmonte Foods’’ Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore Nr.Prot. 25/6785/MMPHI/551/DMM, për veprimtarinë: Objekt frigoriferik me administratë, Harilaq, Fushë Kosovë, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 20.04.2026, në ora: 09:30, në hapësirat e Administrative te Kompanise ‘‘Kosmonte Foods’’ Sh.p.k. Rr. E Antenave, Harilaq, K. Fushë Kosovë, do të organizohet debat publik nga operatori ‘‘Kosmonte Foods’’ Sh.p.k. kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr.Prot. 25/6785/MMPHI/551/DMM, për veprimtarinë: Objekt frigoriferik me administratë, Harilaq, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/73450114005?pwd=HQVWU1UROs6ebu3foZmU13QldhhWfG3.1>

Password: Q8kYL8

Në linkun e mëposhtëm, mund ta gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=kosmonte>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin. Me respekt,

‘‘Kosmonte Foods’’ Sh.p.k. Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, Kompania e Pastrimit ‘‘Fresh’n Clean’’ SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812094192 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa Kompania e Pastrimit ‘‘Fresh’n Clean’’ D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812094192 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability Kompania e Pastrimit ‘‘Fresh’n Clean’’ L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812094192 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Parkun e energjisë me erë ‘‘Zatriqi 1’’ me kapacitet 35 MW në Zatriq, Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.05.2026 në ora 10:00 në ShFMU ‘‘Dëshmorët e Zatriqit’’ fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, do të organizohet debat publik nga Kompania ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA1d2ViLn timer 20udXMvai83MDEyNjUxOTQzP3B3ZD1Kc3lpTVBSNjhwlpEd3dybTJaNTNlVTF4OVRFYnUuMQ==&i=NjY1ZjjiOWVlZmMxZiE3Nzc3ZWVhZmVzcy&t=dlpQdDlaMIR2WEFYTG5ZdGVkaFZicG1qdW5heHBCV3pJQ3BtbUtrZ3dZbz0=&h=2c2ef3fb8cf041dd9b6cfea7b4ba34d3&s=AVNPUehUTONFTkNSWVBUSVZQI9-OG8XD0byKidbWwRoEAiECwK7hNvW5SKAXoFmY8w>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, për pajisje me Pëlqim Mjedisor, për Parkun e energjisë me erë ‘‘Zatriqi 1’’ me kapacitet 35 MW në Zatriq, Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [ynm.komente@rks-gov.net](mailto:ynm.komente@rks-gov.net)

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Parkun e energjisë me erë ‘‘Zatriqi 2’’ me kapacitet 35 MW në Zatriq, Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.05.2026 në ora 11:00 në ShFMU ‘‘Dëshmorët e Zatriqit’’ fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, do të organizohet debat publik nga Kompania ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA1d2ViLn timer 20udXMvai83MDEyNjUxOTQzP3B3ZD1Kc3lpTVBSNjhwlpEd3dybTJaNTNlVTF4OVRFYnUuMQ==&i=NjY1ZjjiOWVlZmMxZiE3Nzc3ZWVhZmVzcy&t=dlpQdDlaMIR2WEFYTG5ZdGVkaFZicG1qdW5heHBCV3pJQ3BtbUtrZ3dZbz0=&h=2c2ef3fb8cf041dd9b6cfea7b4ba34d3&s=AVNPUehUTONFTkNSWVBUSVZQI9-OG8XD0byKidbWwRoEAiECwK7hNvW5SKAXoFmY8w>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë ‘‘Ev Wind Park’’ Sh.p.k., Rahovec, për pajisje me Pëlqim Mjedisor, për Parkun e energjisë me erë ‘‘Zatriqi 2’’ me kapacitet 35 MW në Zatriq, Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [ynm.komente@rks-gov.net](mailto:ynm.komente@rks-gov.net)

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

